



Legal Alert Kosovo

Law on Sustainable Investments No. 08/L-209



Law on Sustainable Investments No. 08/L-209

On August 22, 2024, with the approval of the Assembly of the Republic of Kosovo, the Law on Sustainable Investments (hereinafter referred to as the 'Law') was published in the Official Newspaper of the Republic of Kosovo. The Law aims to promote, support, and protect sustainable investments and exports in the Republic of Kosovo, including the designation of priority sectors for development. Through this Law, Law No. 04/L-220 on Foreign Investments and Law No. 05/L-079 on Strategic Investments in the Republic of Kosovo are repealed.

This law is partially in accordance with Regulation (EU) 2019-452 of the European Parliament and of the Council of March 19, 2019 on the establishment of the framework for the verification of foreign direct investments in the European Union.

Through this law, the Republic of Kosovo promotes and protects responsible and sustainable investments, in accordance with these instruments:

- Principles of responsible investment supported by the United Nations; and
- Declarations and decisions on international investment and multinational enterprises of the Organization for Economic Co-operation and Development (OECD).

Based on this law, some of the state objectives that the Republic of Kosovo intends to fulfill through the promotion and protection of investments are:

- Increase in production and export;
- Promoting the circular economy;
- Increasing the competitiveness of local industry;
- Development of innovation and technology;
- Strengthening the industrial ecosystem and training and employment of the workforce; etc.

By means of this law, the priority sectors for investments have been determined, which are:

- Manufacturing and processing industry;
- Agriculture;
- Information and communication technology;
- Education and training, research and innovation;
- Health;
- Tourism;
- Waste water and waste management;
- Transportation;
- Energy;
- Mines.

Ligji për Investime të Qëndrueshme Nr. 08/L-209

Me datën 22 gusht 2024, me miratimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës është publikuar Ligji për Investime të Qëndrueshme (në tekstin e mëtejme si "Ligji"), i cili ka për qëllim promovimin, përkrahjen dhe mbrojtjen e investimeve të qëndrueshme dhe eksportit në Kosovës, duke përfshirë përcaktimin e sektorëve prioritar për zhvillim. Me anë të këtij ligji, shfuqizohen Ligji Nr. 04/L-220 për Investime të Huaja dhe Ligji Nr. 05/L-079 për Investime Strategjike në Republikën e Kosovës

Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Rregulloren (BE) 2019-452 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 19 marsit 2019 për themelimin e kornizës për verifikimin e investimeve të huaja direkte në Bashkimin Evropian.

Me anë të këtij ligji Republika e Kosovës nxit dhe mbron investimet e përgjegjshme dhe të qëndrueshme, në përputhje me këto instrumente:

- Parimet e investimit të përgjegjshëm të mbështetura nga Kombet e Bashkuara; dhe
- Deklarata dhe vendimet për investimet ndërkombëtare dhe ndërmarrjet shumëkombëshe të Organizatës për Bashkepunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD).

Në bazë të këtij ligji, disa nga objektivat shtetërore që Republika e Kosovës synon t'i përmbush përmes nxitjes dhe mbrojtjes së investimeve janë:

- Rritja e prodhimit dhe eksportit;
- Nxitja e ekonomisë qarkore;
- Rritja e konkurrueshmërisë së industrisë vendore;
- Zhvillimi i inovacionit dhe teknologjisë;
- Fuqizimi i ekosistemit industrial dhe aftësimi dhe punësimi i fuqisë punëtore; etj.

Me anë të këtij ligji, janë përcaktuar sektorët prioritarë për investime, të cilat janë:

- Industria prodhuese dhe përpunuese;
- Bujqësia;
- Teknologjia e informacionit dhe komunikimit;
- Arsimi dhe aftësimi, hulumtimi dhe inovacioni;
- Shëndetësia;
- Turizmi;
- Administrimi i ujërave të zeza dhe mbeturinave;
- Transporti;
- Energjia;
- Minierat.

Based on this law, with investment that meets state objectives and/or priority sectors, investors can benefit from exemptions such as: Import exemptions for production or processing purposes, such as the import of machinery, raw materials, semi-products or other products; Exemption from export obligation; Subsidy of the salary of the citizen of the Republic of Kosovo who is employed or qualified according to the legal norms in force; Support for the purchase of machinery for production or processing; etc.

Also, with the entry into force of this law, two Agencies will be established, which will replace the Agency for Investments and for the Support of Enterprises in the Republic of Kosovo (KIESA) established by the Law on Foreign Investments, which is extinguished. These two Agencies will be: (i) Investments and Exports Agency (AIE) - as an executive agency under the Office of the Prime Minister of the Republic of Kosovo; and (ii) Agency for Innovation and Enterprise Support in the Republic of Kosovo (AISEK) – as an executive agency within the Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade.

The conditions that the investment project must fulfill in order to be announced as a strategic investment, which investment enjoys special advantages and support according to this Law, are:

- The project helps to fulfill state objectives;
- The project coincides with the priority sectors mentioned above;
- The proposer has proven the financial ability to implement the investment;
- The project has been subjected to additional verification if required by law and the decision to authorize the investment has been given.

Also, according to this law, the strategic investment must reach the value of at least ten (10) million euros.

This law also determines that public immovable property can be used for strategic investment after approval by the Assembly of Kosovo or the Municipal Assembly of the respective municipality, depending on the ownership. Public immovable property can be leased for the duration of the strategic investment up to ninety-nine (99) years, according to the relevant law on the lease of property.

Source:[link](#)

Bazuar në këtë ligj, me investim i cili përmbush objektivat shtetërorë dhe/ose sektorët prioritarë, investitorët mund të përfitojnë lehtësira si: Lehtësira në import për qëllime të prodhimit ose përpunimit, siç mund të jetë importi i makinerisë, lëndës së parë, gjysmëproduktit ose produktit tjetër; Lirim nga detyrimi i eksportit; Subvencionim të pagës së shtetasit të Republikës së Kosovës që punësohet ose aftësohet sipas normave ligjore në fuqi; Përkrahje për blerjen e makinerisë për prodhim ose përpunim; etj.

Gjithashtu me hyrjen në fuqi të këtij ligji do të themelohen dy Agjenci, të cilat zëvendësojnë Agjencinë për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës (AIPNK) e themeluar me Ligjin për Investimet e Huaja, e cilat shuhet. Këto dy Agjenci do të jenë: (i) Agjencia e Investimeve dhe Eksporteve (AIE) – si agjenci ekzekutive në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës; dhe (ii) Agjencia për Inovacionin dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës (AIPNK) – si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Kushtet të cilat projekti investues duhet t'i përmbush për t'u shpallur si investim strategjik, i cili investim gëzon përparësi dhe përkrahje të posaçme sipas këtij Ligji janë:

- Projekti ndihmon në përmbushjen e objektivave shtetërore;
- Projekti përkon në sektorët prioritar e cekura më lartë;
- Propozuesi ka dëshmuar aftësinë financiare për ta zbatuar investimin;
- Projekti i është nënshtruar verifikimit plotësues nëse kërkohet sipas ligjit dhe është dhënë vendimi për autorizimin e investimit.

Gjithashtu, sipas këtij ligji, investimi strategjik duhet të arrijë vlerën e së paku dhjetë (10) milionë euro.

Ky ligj percakton gjithashtu që, prona e paluajtshme publike mund të jepet në shfrytëzim për investim strategjik pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës ose Kuvendi Komunal i komunës përkatëse, varësisht nga pronësia. Prona e paluajtshme publike mund të jepet në shfrytëzim për kohëzgjatjen e investimit strategjik deri në nëntëdhjetë e nëntë (99) vjet, sipas ligjit përkatës për dhënie në shfrytëzim të pronës.

Burimi:[link](#)

How can PwC Kosovo help:

- Legal advice to ensure compliance with the law.
- Legal assistance in preparing and submitting proposals for strategic investments, including navigating the screening process.
- Legal assistance in obtaining necessary permits and licenses for your investments, streamlining administrative processes.
- Legal assistance in drafting investment agreements, ensuring legal protection and clarity on responsibilities.

Si mund të ndihmojë PwC Kosova:

- Keshilla ligjore për të siguruar pajtueshmërinë me ligjin.
- Asistencë ligjore në përgatitjen dhe dorëzimin e propozimeve për investime strategjike, duke përfshirë navigimin e procesit të vlerësimit.
- Asistencë ligjore për marrjen e lejeve dhe licencave të nevojshme për investimet, duke thjeshtuar proceset administrative.
- Asistencë ligjore në hartimin e marrëveshjeve të investimeve, duke siguruar mbrojtje ligjore dhe qartësi në përgjegjësi.





PricewaterhouseCoopers Kosovo

Str. Mujo Ulqinaku No. 5 Apt. 10 Qyteza Pejton
Prishtina, Kosovo

Telephone: +383 38 722 555

Email: al_pwc_kosovo@pwc.com

Web: www.pwc.com/ks

